

Në bazë të nenit 184 të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe neneve 264 dhe 265 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Komisioni për arsim, Komisioni për shkencë dhe Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar, pas pranimi të Nismës nga Rektori i Universitetit **Prof. dr. Jusuf Zejneli** për ndarjen e titullit **Doktor nderi - Doctor Honoris Causa për z. Nevzat Halili**, e formoi Komisionin recensues, në përbërje:

1. - kryetar Prof. dr. Jusuf Zejneli
2. – anëtar Prof. dr. Salajdin Salih
3. – anëtar Prof. dr. Berton Sulejmani

Për këtë qëllim, ne si anëtarë të Komisionit recensues e kemi nderin dhe kënaqësinë e veçantë që deri tek organet e Universitetit të Tetovës ta paraqesim këtë:

## REFERAT

### **për dhënien e titullit *Doctor Honoris Causa* për Nevzat Halilit**

Universiteti i Tetovës, si intitucion i arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është themeluar falë ngulmimit dhe sakrificës së përbashkët të popullatës, intelektualëve, faktorit politik shqiptar, diasporës dhe miqve ndërkombëtarë të universitetit. Që nga themelimi, ky universitet, i cili është dëshmuar me të arriturat e veçanta arsimore, shkencore, emancipuese dhe kulturore, ka shprehur mirënjohje dhe respekt të veçantë për figurat e rëndësishme nga sferat e ndryshme shoqërore, qoftë nga hapësira shqiptare, rajonale apo nga ajo botërore, të cilët kanë kontribuar për Universitetin e Tetovës. Njëri nga personalitetet që e mbështeti nismën për themelimin e Universitetit të Tetovës, është edhe **z. Nevzat Halili**, të cilin e propozojmë për dhënien e titullit **Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës**.

Që t'i zbatojmë me përpikëri procedurat ligjore dhe statutare, ne si komision e kemi hartuar referatin për këtë ngjarje të veçantë, gjegjësisht shpalljen si **Doktor nderi - Doctor Honoris Causa për z. Nevzat Halilin.**

Me këtë Referat, i cili përmban pjesën biografike, arsyetimin e dhënies së titullit dhe pjesën përmbyllëse, i propozojmë Senatit të Universitetit, që ta miratojë Vendimin për lauerimin e z. **Nevzat Halili si Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës.**

### **I. Të dhënat mbi jetën dhe veprimtarinë e z. Nevzat Halili**

**Nevzat Halili** lindi në fshatin Poroj të Tetovës më 15 shtator 1946. Ai është diplomuar në vitin 1970 në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi, në Shkup, për Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Disa vite ka punuar si profesor i gjuhës angleze në Shkollën e Mesme të Mjekësisë, “Nikolla Shtejn” në Tetovë, gjithashtu edhe në gjimnazin e Tetovës dhe si ligjërues në Universitetin e Tetovës në vitin akademik 1993-1996 si dhe në vitin 2007-2009.

Nevzat Halili ishte kryetari i parë i Partisë për Prosperitet Demokratik, me seli në Tetovë. Kjo ishte partia e parë shqiptare në sistemin shumëpartiak në Maqedoni, e cila u formua më 16 prill 1990, në fshatin Xhepçisht të Tetovës dhe u regjistrua si parti më 25 maj 1990.

Partia për Prosperitet Demokratik bashkoi popullatën dhe intelektualët shqiptarë për realizimin e kërkesave kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni.

Nevzat Halili ishte edhe njëri nga prijatarët për organizimin e Referendumit për Autonomi Politiko - Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni. Referendumi u mbajt më 11 dhe 12 janar të vitit 1992. Ai u organizua pas përfundimit të referendumit për pavarësinë e Republikës së Maqedonisë më 8 shtator dhe pas aprovimit të Kushtetutës së vitit 1991. Referendumi u përkrah nga 92 përqind e popullatës shqiptare të Maqedonisë.

Nevzat Halili punoi me përkushtim dhe ndershmëri të pashoqe për çështjen shqiptare, në përgjithësi dhe për të realizimin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, në veçanti.

Emri i Nevzat Halilit është i lidhur ngushtë edhe me historinë e themelimit të Universitetit të Tetovës. Ai e mbështeti themelimin e Universitetit të Tetovës në kohën kur qeveria e atëhershme maqedonase i përdori të gjitha mekanizmat e dhunës për ta pamundësuar funksionimin e këtij universiteti.

Nevzat Halili ishte pjesëmarrës i rezistencës kundër vendimeve dhe veprimeve të qeverisë maqedonase që kishin si qëllim mbylljen e Universitetit të Tetovës. Ai deklaroi se Universiteti i Tetovës nuk mund të mbyllej dhe se këtu ishte vija e kuqe që nuk guxonte të kalohej nga pushteti i atëhershëm.

## **II. Arsyetimi i dhënies së titullit Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës**

Pedagogu, intelektual i dhe veprimtari politik e shoqëror z. Nevzat Halili dha kontribut të çmuar për afirmimin e vlerave të demokracisë e lirisë dhe punoi për respektimin e lirive dhe të drejtave kombëtare e njerëzore. Veprimtaria jetësore, shoqërore dhe politike e Nevzat Halilit është e lidhur ngushtë me çështjen shqiptare, në përgjithësi, por edhe me historinë e themelimit të Universitetit të Tetovës, në veçanti. Dhënia e titullit Doctor Honoris Causa për Nevzat Halilin, vlerësojmë se e nderon Universitetin e Tetovës.

### Propozim-vendim

Me sa u parashtua më sipër dhe duke u bazuar në personalitetin dhe aktivitetet e dëshmuara të z. **Nevzat Halili** në fushën e arsimit, politikës dhe jetës publike, Komisioni vlerësues jep miratimin **për dhënien e titullit Doctor Honoris Causa të Universitetit të Tetovës z. Nevzat Halili** dhe njëkohësisht i propozojmë Senatit, si organ më i lartë i Universitetit, që ta marrë në konsideratë vlerësimin tonë.

Tetovë, nëntor 2024

Komisioni në përbërje:

1. - kryetar

Prof. dr. Jusuf Zejneli 

2. – anëtar

Prof. dr. Salajdin Salihi 

3. – anëtar

Prof. dr. Bertan Sulejmani 